

Njoftim

Pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, për llogari të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, është paraqitur për shqyrtim çështja Nr.29 Regj. Themeltar, Datë 09.06.2023 Regjistrimi, me:

Paditës: Koalicioni “Bashkë Fitojmë”.

I paditur: Komisionit Qendror i Zgjedhjeve – KQZ.

Objekti: Ndryshimin e Vendimit nr.176, datë 07.06.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, duke vendosur:
Prishjen e Vendimit të KSHZ nr.536, datë 20.05.2023 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në Zonën Zgjedhore Bashkia Kamëz, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 14 maj 2023”, duke vendosur:
(i) Pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në zonen zgjedhore Bashkia Kamëz; dhe
(ii) Përsëritjen e zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë si dhe të Këshillit Bashkiak Kamëz me anë të votimit tradicional me fletë votimi fizike.

Më datë **12.06.2023** u hodh shorti publik për përcaktimin e përbërjes së Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor dhe, sipas tij, trupi gjykues përbëhet nga gjyqtarët:

- 1. Edlira Petri (Relatore);**
- 2. Esmeralda Xhili (Anëtare);**
- 3. Manjola Xhaxho (Anëtare);**
- 4. Sokol Ibi (Anëtar);**
- 5. Emona Muçi (Anëtare).**

Me Urdhër datë 13.06.2023 “Për caktimin e seancës gjyqësore” të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor është caktuar data **15.06.2023, ora 16:00**, për zhvillimin e seancës gjyqësore.

Lidhur me ambientin e zhvillimit të seancës gjyqësore, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor caktoi **Gjykatën Administrative të Apelit, në adresën Rr.“Ismail Qemali”, Njësia Bashkiake nr. 2, Tiranë**, në kushtet kur prej njoftimeve të datave 12.06.2023 dhe 13.06.2023, në grupin e gazetarëve në aplikacionin ËhatsApp, nuk pati asnjë konfirmim për pjesëmarrje në seancë, çka do të diktonte zhvillimin e seancës në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Tiranë, më 14.06.2023.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë